



NJOFTIM PËR APLIKIM

PËR OPERATORËT E PARKINGJEVE PRIVATE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

NJOFTOHEN të gjithë operatorët e parkingjeve ekzistuese dhe operatorët e rinj, që duan të organizojnë dhe shfrytëzojnë parkingjet private në territorin e komunës së Prishtinës, se fillon aplikimi për t'u pajisur me leje për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Bazuar në Rregulloren nr. 01-030/01-236535/23, dt. 26.12.2023, për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve në komunën e Prishtinës, neni 4, paragrafi 3, Drejtoria e Shërbimeve Publike shpall këtë njoftim për aplikim për operatorët e parkingjeve private në territorin e komunës së Prishtinës.

Personat juridikë, të cilët aplikojnë për t'u pajisur me licencë për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit në ARBK, për këtë lloj veprimtarie;
- Marrëveshjen apo kontratën origjinale të noterizuar me pronarin-ët e ligjshëm për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar si vendparkim;
- Projektin për kyçje dhe funksionet e hapësirës së vendparkimit, të hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor, pjesë e stafit të ndonjë kompanie të licencuar, në tri kopje fizike dhe DWG file (CD), me përmbajtjet e lartcekura, në format A3, me ngjyra, situacioni i gjerë, paraqitja mbi ortofoto 1:250;
- Incizimin gjeodezik të hapësirës së vendparkimit, objekteve dhe rrugës ku do të bëhet kyçja;
- Hapësira për vendparkim të ketë së paku 10 vendparkime (një vendparkim të jetë i rezervuar për personat me aftësi të kufizuara);

- Kyçja të mos lejohet në rrugën e cila ka më tepër se dy korsi për kahe të njëjtë të lëvizjes;
- Parkingu duhet të ketë qasje direkte në rrugë, të mos kalojë përmes trotuarit;
- Të ketë shenjëzimin horizontal dhe vertikal, sipas Udhëzimit administrativ (MI) nr. 09/2017, për sinjalizim dhe Rregullat e trafikut rrugor;
- Projekti i shenjëzimit horizontal dhe vertikal 1:100; dimensionimi i vendparkimeve dhe rrugës qarkulluese duhet të prezantohet sipas kushteve të parapara në Rregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës;
- Matjet gjeodezike të realizohen nga gjeodet i licencuar dhe situacioni i incizimit gjeodezik me të gjitha objektet ekzistuese, i nënshkruar nga hartuesi i dokumentacionit;
- Shtrimin me kubze betoni, asfalti të ketë përshkrim dhe specifikacioni teknik i shtresës së materialit për rregullimin e hapësirës së vendparkimeve;
- Të ketë sistemin e kamerave, në prezantimin grafik të vendosjes së kamerave, të parashihet kabina, zyra për monitorim të hapësirës së vendparkimeve dhe vëzhgimit përmes kamerave, si dhe vendosja e ndriçimit të jashtëm (për ndriçimin e vendparkimeve). Një objekt maksimum për kabinë zyre, duhet të jetë deri në 10m²; të ketë së paku një tualet në shërbim të klientëve dhe të stafit (objekti i tualetit mund të jetë mobil, nga materiali i plastikes apo i ngjashëm, me dimensione deri në 6m²).
- Dorëzimi i projektit për hapësirën e vendparkimeve dhe incizimi gjeodezik, të bëhet në tri kopje fizike, lidhje të fortë, e vulosur dhe e nënshkruar, një kopje digjitale në file DWG- në CD, dhe gjashtë kopje të situacionit të hapësirës së vendparkimeve me përmbajtjet e lartcekura në format A3, me ngjyra.

Aplikimi së bashku me dokumentet e lartshënuara, duhet të dorëzohet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, kati përdhes (për Drejtorinë e Shërbimeve Publike).

Afati për dorëzimin e aplikacionit është i hapur, nga data 25.03.2024 deri më 26.04.2024

Vërejtje: Në rast se operatorët ekzistues nuk aplikojnë që të pajisen me leje brenda afatit të përcaktuar, Drejtoria e Inspeksionit fillon shqiptimin e gjobave të parapara sipas dispozitave ndëshkuese të Rregullores nr. 01-030/01-236535/23, dt. 26.12.2023, për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës.